



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 04.11.2016, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK–03-02-2955/16, për znj. Florentina Elezi, Anëtare e Kuvendit Komunal në Drenas, për shkak se zyrtarja e lartë publike e ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik për zyrtaren e lartë, znj. Florentina Elezi, Anëtare e Kuvendit Komunal në Drenas, dhe njëkohësisht pronar dhe person i autorizuar në biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Zyrtarja i lartë është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pas pranimit të kësaj shkrese kemi organizuar një takim me zyrtaren e lartë. Gjatë këtij takimi znj. Elezi është njoftuar se gjatë ushtrimit të funksionit publik nuk mund të ushtrij funksion menaxherial në biznes privat, neni 15 (paragraf 1), të Ligjit nr.04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, në të cilën shprehimisht thuhet:

“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, anëtar i ndonjë organi menaxhues apo kontrollues i ndërmarrjeve private”.

Zyrtares së lartë i është rekomanduar nga Agjencia që të heq dorë nga funksioni menaxherial apo të mbyllë biznesin privat, për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

Ndërkohë, znj. Elezi ka dërguar në Agjenci shkresen zyrtare (DPKI.03-02/3869/16), me të cilën vërtetohet se zyrtarja e lartë ka bërë shuarje vullnetare në biznesin privat B.I “Florentina Elezi”.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

